



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 593/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 200 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga BIRN, në të cilën theksohet se me datën 02.11.2013 Eqrem Kryeziu nga subjekti politik LDK ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të një statusi dhe publikimin e një fotografie, andaj me këtë rast sipas parashtresës të ankesës ky veprim bie ndesh me dispozitat e LZP-së

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 05.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.11.2013, ora 10:00. PZAP-i sipas afatit të caktuar pranoi përgjigjen në ankesë nga LDK-ja e në të cilën theksohet se në emër të Eqrem Kryeziut ekzistojnë dhjetëra llogari të hapura në rrjetin social të cilat nuk janë krijuar dhe nuk menaxhohen nga personi në fjalë apo nga njerëz të autorizuar nga ai. Në përgjigje në ankesë më tutje theksohet se janë të dyshimta pohimet e BIRNIT rreth gjetjes se orës së saktë të postimit nga ane e personave të tyre të teknologjisë informative pasi që këta persona janë të panjohur për LDK dhe se për këtë ngrehin bazën e dyshimit dhe se fotografia e ofruar si dëshmi nuk garanton vërtetësinë e sajë si dhe autorësinë e sajë dhe në të njëjtën kohë nuk thërret për të votuar dhe se nuk konsiderohet si shkelje e heshtjes zgjedhore. Andaj mbi këtë bazë LDK propozon që ankesa të hedhet si e pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës shihet qartë se si kandidati i LDK Eqrem Kryeziu me datën 02 nëntor gjatë heshtjes zgjedhore duke bërë fushatë dhe duke bërë postimin e fotografisë të fushatës zgjedhore, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) të LZP-së e cilat përcaktonë që njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të voimit për hedhjen e votes e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mështetesve ose kandidateve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfardo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik LDK në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj mbi këtë bazë si dhe në kuptim të nenit 36.1 pika b) dhe nenit 118.1 lidhur me neni 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 593/2013 më datën 07.11.2013.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*